

Lënia e shtetësisë

Përshkrimi

Heqja dorë nga shtetësia shqiptare, në rast se është marrë një shtetësi tjetër ose është marrë premtimi për marrjen e një shtetësie tjetër.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Kërkesa e shtetasit shqiptar drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë
- 2) Premtimi nga autoriteti kompetent i shtetësisë tjetër ose dokument shtetësie origjinal, marrë në vendin përkatës;
- 3) Certifikata e lindjes e aplikuesit;
- 4) Dëshmi penaliteti;
- 5) Vërtetim nga gjykata e rrethit;
- 6) Vërtetim nga prokuroria;
- 7) Vërtetim nga zyra e përmbarimit;
- 8) Vërtetim nga kryetari i njësisë administrative që është banor i asaj njësie, në të cilën konfirmohet adresa e saktë;
- 9) Certifikatë martesë e aplikuesit, nëse është i martuar;
- 10) Certifikatë e gjendjes familjare në shtetin ku banon;
- 11) Deklarata noteriale e të dy prindërve, ku të shprehet pëlqimi i tyre për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare e fëmijëve të tyre të moshës së mitur;
- 12) Dokumenti që vërteton vendbanimin e tij në shtetin premtues të shtetësisë tjetër;
- 13) Mandat pagesa.

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja e dokumentacionit me postë ose personalisht;
- 2) Verifikimi i dokumentacionit nga konsulli;
- 3) Përcjellja e dokumentacionit zyrtarisht nga përfaqësia për autoritetet përgjegjëse.

Tarifa e shërbimit dhe afati

30 euro

3 muaj

Zyra

Të gjitha përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime

Të gjitha dokumentet e lëshuara në Republikën e Shqipërisë pranohen kur janë nënshkruar nga titullari i institucionit. Aplikimet për lënien e shtetësisë shqiptare janë individuale, veç atyre të shtetasve mitur, për të cilët shprehen prindërit e tyre. Dokumentacioni duhet të jetë i dy muajve të fundit.

Të gjitha dokumentet (të prodhuara në Shqipëri apo në vende të tjera) pranohen kur janë në harmoni të plotë me njëri tjetrin, pa gabime e korrigjime.

Të gjitha dokumentet për heqje dorë nga shtetësia sigurohen nga vetë të interesuarit.

Pagesa e tarifës së shërbimit konsullor kryhet nëpërmjet bankës.